

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Nr.prok. 216-26-2603-1-3-6** nr, brendshem.:

Sa i përket tenderit për **Furnizim me veshmbathje për ngasës të automjeteve zyrtare të MPJD-së RITENDER**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"RIMI ALTEX" Shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Deshmoret e kombit

(Adresa)

Ferizaj

(Vendi)

+383 44 164 991

(Numri Telefonit)

Trim Goga

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

rimi-altex@hotmail.com

(Adresa elektronike)

70000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)



(Nënshkrimi dhe)

06.09.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontratë 22.04.2026
- Afati i fundit për dorëzim të tenderit 04.05.2026
- Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit 28.08.2026
- Kriteret e Dhenies së tenderit: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

- Me datën 29.08.2026 nepermjet portalit të KRPP-se kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim, AK me datën 01.09.2026 na kthen Vendimin dhe Kërkesën tone për Rishqyrtim e refuzon si të pabazuar. Në Vendimin e Kërkesë për Rishqyrtim shkruan: I. REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik RIMI-ALTEX e datës 29.08.2026 kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 28.08.2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me veshmbathje për ngasës të automjeteve zyrtare të MPJD-se" RITENDER me numër të prokurimit 216-26-2603-1-3-6, dhe AUTORIZOHET autoriteti kontraktues - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në piken I të këtij vendimi-ku AK ka anuluar këtë procedurë të prokurimit

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Vlersimi i aktivitetit të prokurimit është në kundërshtim me Ligjin prokurimit Publik,

- Shkelja e nenit 1-Qellimi i LPP-se të amandamentuar
- Shkelja e Nenit 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti (LPP)
- Shkelja e nenin 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP të

amandamentuar

- *Nenin 59 Ekz. Vler. dhe Krah. i Tendereve te LPP te amandamentuar,*
- *Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjorbë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Shoqëria "RIMI ALTEX" Shpk me seli në Ferizaj (me tej: Kerkuesi), brenda afatit ligjor të paraparë me dispozitën e Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 për ANKESE, respektivisht, brenda afatit të lënë për ANKESA paraqet këtë:

ANKESË

kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim dhe kundër vendimit për anulim të kësaj procedure të prokurimit, për shkak të:

- *konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;*
- *zbatimit të gabuar të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik;*
- *shkeljes së parimeve të transparencës, trajtimit të barabartë dhe vlerësimit objektiv të ofertave.*

PROPOZOJME QË PANELI SHQYRTUES

- 1. Ta aprovojë ankesën si të bazuar;*
- 2. Ta anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim;*
- 3. Ta anulojë vendimin për anulimin e kësaj procedure të prokurimit ;*
- 4. Ta kthejë lëndën në rivlerësim;*
- 5. Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që vlerësimin ta bëjë vetëm mbi bazën e kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe provave objektive e të verifikueshme.*

Operatori Ekonomik RIMI-ALTEX SH.P.K., në afatin e përcaktuar ligjor, paraqet këtë ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 01.09.2026, me të cilin është refuzuar si e papabuar Kërkesa jonë për Rishqyrtim e datës 29.08.2026.

Kërkesa për Rishqyrtim kishte të bënte me:

- *Letrën Standarde B42, datë 28.08.2026, me të cilën RIMI-ALTEX SH.P.K. është shpallur tenderues i përgjegjshëm; dhe*
- *Njoftimin B58, datë 28.08.2026, me të cilin aktiviteti i prokurimit është anuluar për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme.*

RIMI-ALTEX SH.P.K. konsideron se Vendimi i AK-së i datës 01.09.2026 është i pabazuar në fakte dhe në kërkesat e publikuara të Dosjes së Tenderit, për arsye se AK nuk ka identifikuar asnjë kërkesë konkrete të Dosjes së Tenderit e cila është shkelur nga mostra e dorëzuar për Pozicionin 7.

Në vend të kësaj, AK ka mbështetur eliminimin në karakteristika si mbushja, trashësia dhe mungesa e shtresës së heqshme, ndonëse këto nuk janë përcaktuar si kërkesa konkrete teknike në Dosjen e Tenderit.

RIMI-ALTEX SH.P.K. ka marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit me nr. 216-26-2603-1-3-6, për "Furnizim me veshmbathje për ngasës të automjeteve zyrtare të MPJD-së RITENDER".

Në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit, RIMI-ALTEX SH.P.K. fillimisht është shpërblyer me kontratë më datë **18.05.2026**.(shtojce)

Pas ankesës së një Operatori Ekonomik, me Vendimin e OSHP-së të datës **22.06.2026**, lënda është kthyer në rivlerësim. Pasi lenda u kthye ne rivlerësim, me datë **02.07.2026**, Autoriteti Kontraktues ka shpallur fitues OE SHUKI qe ky kishte ka bere Ankesë ne OSHP, **ndërsa RIMI-ALTEX SH.P.K. është shpallur tenderues i pasuksesshëm.**

Pas kesaj RIMI-ALTEX SH.P.K. ka ushtruar ankesë pranë OSHP-së.

Me **Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0497, datë 21.08.2026**, Paneli Shqyrtues e ka aprovuar pjesërisht ankesën, ka anuluar vendimin përkatës të AK-së dhe e ka kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim.

Në këtë vendim, OSHP ka udhëzuar Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit t'u përmbahet në tërësi dispozitave ligjore, Njoftimit për Kontratë, Dosjes së Tenderit, specifikimeve teknike të detyrueshme dhe mostrave.

Megjithatë, pas kthimit të lëndës në rivlerësim, më **28.08.2026**, Autoriteti Kontraktues ka:shpallur të papërgjegjshëm të gjithë pesë (5) Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës;dhe ka anuluar aktivitetin e prokurimit në mungesë të ofertave të përgjegjshme; dhe për RIMI-ALTEX SH.P.K. ka dhënë si arsye të vetme mospërputhjen e pretenduar të **Pozicionit 7 – Pallto trench klasik**.ku RIMI-ALTEX SH.P.K. e kundërshton këtë konstatim si faktikisht dhe juridikisht të pabazuar.

Për Pozicionin 7, Dosja e Tenderit ka përcaktuar:"Pallto trench klasike, me gjatësi mesatare, e përshtatshme për t'u veshur mbi kostum, rezistente ndaj ujit, ngjyra blu errët ose e zezë, për përdorim gjithsezonal."

Kjo është kërkesa që operatorët ekonomikë kanë pasur në dispozicion për përgatitjen e ofertave dhe për të cilën është dorëzuar mostra.

Në këtë përshkrim teknik nuk është përcaktuar shprehimisht:

- që palltoja duhet të jetë pa mbushje;
- që palltoja duhet të ketë shtresë të heqshme;
- që astari ose izolimi duhet të jetë i heqshëm;
- trashësia maksimale e palltos;
- gramazhi maksimal i materialit ose mbushjes;
- temperaturat e përdorimit;
- ndonjë standard teknik që përcakton "gjithësezonalitetin"; apo
- ndonjë kriter tjetër teknik objektiv që përcakton se kur një pallto konsiderohet "për përdorim gjithsezonal".

Nga Vendimi i AK-së i datës 01.09.2026 rezulton se AK e konsideron mostrën e RIMI-

ALTEX SH.P.K. si të papërshtatshme për përdorim gjithsezonal, kryesisht për shkak të:

- mbushjes së palltos;
- trashësisë së saj;
- dhe mungesës së mundësisë për heqjen e shtresës së trashë.

AK argumenton më tej se do të ishte e papërshtatshme që një pallto e tillë të përdorej në pranverë, verë dhe vjeshtë.

Mirëpo, në Vendimin e saj AK nuk identifikon dispozitën konkrete të Dosjes së Tenderit ku përcaktohet se:

- a) mbushja është e ndaluar;
- b) palltoja duhet të ketë shtresë të heqshme;
- c) palltoja duhet të ketë një trashësi të caktuar;ose
- d) vetëm një pallto me shtresë të heqshme mund të konsiderohet “për përdorim gjithsezonal”.

AK KA SHNDËRRUAR NJË PËRSHKRIM TË PËRGJITHSHËM NË NJË KRITER TEKNIK TË RI Kërkesa “për përdorim gjithsezonal” është pjesë e specifikimit teknik, por Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar mënyrën objektive se si do të matet apo verifikohet ky kriter.

Në këto rrethana, AK nuk mund gjatë fazës së vlerësimit të përcaktojë për herë të parë se:

- “gjithësezonal” do të thotë pa mbushje;
- “gjithësezonal” do të thotë me shtresë të heqshme;
- “gjithësezonal” do të thotë një trashësi e caktuar;
- ose se një pallto me mbushje automatikisht është vetëm për sezonin vjeshtë-dimër.

Nëse këto karakteristika do të ishin të domosdoshme për përmbushjen e kërkesës teknike, ato është dashur të përcaktohen qartë në Dosjen e Tenderit përpara paraqitjes së ofertave.

Operatorët ekonomikë duhet të përgatisin ofertat e tyre mbi bazën e kërkesave të publikuara dhe jo mbi bazën e kritereve që mund të krijohen gjatë vlerësimit.

AK në Vendimin e saj argumenton se produktet gjithësezonale mund të kenë shtresë të heqshme, e cila mundëson përshtatjen e palltos me stinët e ndryshme.

Ky arsyetim nuk e zgjidh çështjen e ngritur nga RIMI-ALTEX SH.P.K.

Fakti se në treg ekzistojnë pallto gjithësezonale me shtresë të heqshme nuk do të thotë se shtresa e heqshme është kërkesë e detyrueshme e këtij tenderi.

Nëse AK ka konsideruar se kjo karakteristikë ishte kusht i domosdoshëm për Pozicionin 7, atëherë ajo është dashur të jetë pjesë e specifikimit teknik të publikuar.

RIMI-ALTEX SH.P.K. nuk mund të eliminohet për një karakteristikë që nuk është kërkuar shprehimisht në DT.

Edhe mbushja dhe trashësia janë përdorur nga AK si elemente kryesore për të arritur në përfundimin se mostra nuk është gjithsezonale.

Megjithatë, AK nuk ka identifikuar:

- ndonjë trashësi maksimale të përcaktuar në DT;
- ndonjë gramazh maksimal;
- ndonjë lloj të ndaluar të mbushjes;
- ndonjë standard teknik;
- ndonjë interval temperaturash;
- apo ndonjë metodë objektive testimi.

Për këtë arsye, përfundimi se “palltoja është shumë e trashë” nuk mjafton në vetvete për të provuar shkeljen e një kërkesë të DT-së.

Pyetja që duhet të përgjigjet është:

Cila kërkesë konkrete e Dosjes së Tenderit është shkelur nga mbushja ose trashësia e mostrës?Vendimi i AK-së nuk jep përgjigje konkrete në këtë pyetje.

AK përdor edhe argumentin se do të ishte e papërshtatshme që palltoja e paraqitur të vishej gjatë stinëve të ngrohta.

Ky është një vlerësim i AK-së mbi përshtatshmërinë praktike të produktit, por nuk shoqërohet me një kriter teknik të përcaktuar në DT.

Nëse AK do të kërkonte një pallto që mund të përdoret brenda një intervali të caktuar temperaturash, ose një produkt me karakteristika të caktuara izoluese, këto kërkesa është dashur të përcaktohen paraprakisht.

Nuk mund të kërkohej nga operatorët ekonomikë që të parashikojnë një standard teknik të cilin AK nuk e ka publikuar.

Vendimi i OSHP-së nr. 2026/0497, datë 21.08.2026, është veçanërisht i rëndësishëm për këtë çështje.

Me këtë vendim, Paneli Shqyrtues ka anuluar vendimin përkatës të AK-së dhe e ka kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim.

Paneli ka kërkuar që AK gjatë rivlerësimit të respektojë në tërësi:

- dispozitat e LPP-së;
- Njoftimin për Kontratë;
- Dosjen e Tenderit;
- specifikimet teknike të detyrueshme;
- dhe mostrat.

Në vendim evidentohet gjithashtu problemi se Dosja e Tenderit nuk e kishte përcaktuar konkretisht se çfarë përbën një pallto trench “për përdorim gjithsezonal”.

Për këtë arsye, Vendimi 2026/0497 nuk mund të interpretohet si autorizim për AK-në që gjatë rivlerësimit të krijojë kritere të reja.

Përkundrazi, detyrimi i AK-së ishte që rivlerësimin ta kryente në përputhje me kërkesat ekzistuese dhe të publikuara të DT-së.

AK në Vendimin e saj i referohet edhe vlerësimit të mëparshëm të ekspertit dhe Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0361.RIMI-ALTEX SH.P.K. nuk e mohon se çështja e palltos është trajtuar në procedurat e mëparshme.

Megjithatë, raporti i ekspertit nuk është pjesë e Dosjes së Tenderit dhe nuk mund të krijojë një kriter të ri teknik për operatorët ekonomikë.

Për më tepër, në Vendimin nr. 2026/0497 evidentohet se raporti i ekspertizës nuk është konsideruar bazë e mjaftueshme profesionale për një vendimmarrje të sigurt dhe meritorë.

Prandaj, AK nuk mund ta përdorë interpretimin e mëparshëm të ekspertit si zëvendësim të një kërkesë teknike të cilën vetë AK nuk e ka përcaktuar në DT

Në Vendimin e datës 01.09.2026, AK sqaron se rezistenca ndaj ujit nuk ka qenë arsye për shpalljen e RIMI-ALTEX SH.P.K. si tenderues të papërgjegjshëm dhe se nuk është kryer testim për këtë çështje.

RIMI-ALTEX SH.P.K. e merr këtë sqarim në konsideratë dhe nuk e paraqet këtë çështje si bazë të pavarur të kësaj ankese.

Megjithatë, ky sqarim e konfirmon se arsyet reale e eliminimit lidhet me mbushjen, trashësinë dhe mungesën e shtresës së heqshme – karakteristika të cilat, siç u argumentua më sipër, nuk janë përcaktuar si kërkesa konkrete në DT.

AK deklaron se të gjitha veprimet e ekzaminimit dhe vlerësimit janë kryer në përputhje me Nenin 59 të LPP-së.RIMI-ALTEX SH.P.K. nuk konteston të drejtën e AK-së për të ekzaminuar mostrën. Çështja është kundrejt cilave kërkesa të publikuara në DT është bërë ky vlerësim.

Respektimi i procedurës së ekzaminimit nuk mjafton nëse përfundimi për mospërgjegjshmërinë mbështetet në një kriter që nuk është përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Në rastin konkret, AK duhej të tregonte qartë:

Kërkesa e DT-së → karakteristika e kërkuar → karakteristika e mostrës → mospërputhja konkrete.

Kjo rrjeshmeri konkrete mungon në arsyetimin e Vendimit të datës 01.09.2026.

AK sqaron se procedura është anuluar për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme dhe se baza e anulimit është paraparë në nenet 43.7 dhe 44.2 të Rregullores.

RIMI-ALTEX SH.P.K. nuk konteston në mënyrë abstrakte mundësinë e anulimit të një procedure kur nuk ekziston asnjë ofertë e përgjegjshme.

Mirëpo, në rastin konkret, përfundimi se nuk ka oferta të përgjegjshme është i lidhur drejtpërdrejt me vlerësimin individual të ofertave.

Për RIMI-ALTEX SH.P.K., konstatimi i mospërgjegjshmërisë është bazuar në eliminimin për Pozicionin 7.

Nëse ky eliminim rezulton të jetë i pabazuar, atëherë duhet të rishqyrtohet edhe përfundimi pasues se nuk ekzistojnë oferta të përgjegjshme.

Prandaj, anulimi nuk mund të konsiderohet i qëndrueshëm pa u shqyrtuar paraprakisht ligjshmëria e bazës mbi të cilën RIMI-ALTEX SH.P.K. është shpallur i papërgjegjshëm.

PARIMET E TRANSPARENCËS DHE TRAJTIMIT TË BARABARTË.-Operatorët ekonomikë duhet të konkurrojnë mbi bazën e kërkesave të publikuara në dokumentet e tenderit.

Nëse gjatë vlerësimit përdoret si kriter eliminues një karakteristikë e cila nuk është përcaktuar në DT, atëherë operatorët ekonomikë nuk janë duke u vlerësuar mbi bazën e kushteve që kanë qenë të njohura paraprakisht.

Në rastin konkret, përdorimi i:

- mungesës së mbushjes;
- ekzistencës së shtresës së heqshme;
- ose një trashësie të caktuar,

si kriter vendimtar për përmbushjen e kërkesës “për përdorim gjithsezonal”, pa qenë këto kërkesa të përcaktuara në DT, **cenon parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë.**

Nga analiza e Vendimit të AK-së të datës 01.09.2026, Kërkesës për Rishqyrtim dhe Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0497 rezulton se çështja thelbësore nuk është nëse AK mund të ketë një mendim të caktuar për mënyrën se si duhet të duket një pallto gjithësezonale.

Çështja thelbësore është nëse ky mendim është mbështetur në një kërkesë konkrete, të publikuar dhe të detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

AK nuk ka identifikuar një dispozitë të DT-së që kërkon:

- pallto pa mbushje;
- shtresë të heqshme;
- astar të heqshëm;
- trashësi të caktuar;
- gramazh të caktuar;
- ose ndonjë standard tjetër teknik që përcakton “gjithësezonalitetin”.

Për këtë arsye, konsiderojmë se eliminimi i RIMI-ALTEX SH.P.K. për Pozicionin 7 është mbështetur në karakteristika të cilat nuk janë përcaktuar si kërkesa konkrete në Dosjen e Tenderit.

Një vlerësim i tillë nuk është në përputhje me detyrimin për të vlerësuar ofertat dhe mostrat mbi bazën e kërkesave të publikuara dhe as me detyrimin e AK-së për të zbatuar Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0497 gjatë rivlerësimit.

Duke u bazuar në të gjitha pretendimet dhe faktet e paraqitura në këtë ankesë, RIMI-ALTEX SH.P.K. i propozon Panelit Shqyrtues që:

1. *Ta aprovojë ankesën si të bazuar;*
2. *Ta anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 01.09.2026, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e RIMI-ALTEX SH.P.K.;*
3. *Ta anulojë konstatimin e datës 28.08.2026, përkatësisht Letrën Standarde B42, në pjesën me të cilën RIMI-ALTEX SH.P.K. është shpallur tenderues i papërgjegjshëm për shkak të mospërputhjes së pretenduar të Pozicionit 7;3.*
4. *Ta anulojë Njoftimin për Anulim B58, datë 28.08.2026, dhe ta kthejë aktivitetin e prokurimit në rivlerësim;*
5. *Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit ta bëjë vlerësimin e ofertave dhe veçanërisht të Pozicionit 7 të RIMI-ALTEX SH.P.K., vetëm në bazë të kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, specifikimeve teknike të publikuara dhe mostrës së dorëzuar, në përputhje me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0497;*
6. *Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit të mos përdorë si bazë për eliminim karakteristika, kritere ose kërkesa teknike të cilat nuk janë përcaktuar në Dosjen e Tenderit, përfshirë kërkesën për shtresë të heqshme, mungesën e mbushjes ose ndonjë trashësi të caktuar, nëse një kërkesë e tillë nuk rezulton nga dokumentet e tenderit;*
7. *Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që për çdo konstatim të mospërputhjes së mostrës me kërkesat teknike të japë arsyetim konkret, të qartë, objektiv dhe të verifikueshëm, duke identifikuar kërkesën konkrete të Dosjes së Tenderit me të cilën pretendohet se produkti nuk është në përputhje;*
8. *Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që rivlerësimin ta kryejë në përputhje të plotë me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0497, datë 21.08.2026, si dhe me LPP-në, Njoftimin për Kontratë, Dosjen e Tenderit, specifikimet teknike dhe mostrat;*
9. *Në rast se Paneli Shqyrtues vlerëson se nga provat dhe dokumentacioni i administruar nuk mund të merret vendim përfundimtar mbi përgjegjshmërinë e RIMI-ALTEX SH.P.K. për Pozicionin 7, ta kthejë çështjen në rivlerësim me udhëzime të qarta dhe detyruese për Autoritetin Kontraktues, në mënyrë që vlerësimi i ardhshëm të bëhet vetëm mbi kriteret e publikuara në Dosjen e Tenderit dhe mbi një arsyetim objektiv e të verifikueshëm.*

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani shumë serioze, me një përvojë shume te gjate në këtë fushë

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*